



Japonezja Umeji Narisawa (99 vjeçare) çmendet pas lojës Bomberman në Nintendo, të cilën ka filluar ta luajë para 26 vitesh, pasi që e kishte parë nipin e saj duke luajtur.

Kjo loke luan edhe nga disa orë në ditë dhe kjo punë i është bërë rutinë. Japonezja me kalimin e viteve u bë eksperte për Bomberman, ndërsa disa herë i ka kaluar 50 nivele.

Nëse gjithçka shkon si duhet ajo mund ta përfundojë lojën edhe nga dy herë radhazi. Ajo thotë se loja i ndihmon ta mbajë mendjen e mprehtë, ndërsa duke mbajtur joy-stickun në dorë i janë forcuar edhe gishtat. Gjyshja pranon se vetëm sfidat e mbajnë gjallë në këtë jetë./kuriozitet/

yAYUjBgbdro